



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.10.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- 1- Miratimi i procesverbaleve të datave 2 dhe 7 tetor 2019
- 2- Seancë dëgjimore për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën dhjetor 2018 – korrik 2019

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Aurora Mara, Ediola Braha, Adriatik Alimadhi, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Damian Gjikhuri, Elda Hoti, Nikolin Staka dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Gent Ibrahim- Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Alfred Balla- Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Ilirjana Nano- Sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Edlira Cimbi-Drejtoresh e Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Kuorumi plotësohet për të vazhduar me rendin e ditës.

Si pikë e parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 2 dhe 7 tetor të vitit 2019 të Komisionit të Ligjeve. Procesverbalet ju kanë ardhur nëpërmjet postës elektronike. A ka vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohe procesverbalet e datave 2 dhe 7 tetor të vitit 2019.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës. Seancë dëgjimore për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për periudhën dhjetor 2018 – korrik 2019. Komisioni ynë është komision përgjegjës në këtë raportim që bën sot përpara komisionit KLP-ja. Relatore është kolegja Klotilda Bushka.

Sot prezent në Komisionin e Ligjeve kemi zotin Gent Ibrahim, kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Zoti Ibrahim, mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve! Kemi gjithashtu të pranishëm zotin Alfred Balla, zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, mirë se erdhët, zoti Balla! Ilirjana Nano, sekretare e Përgjithshme e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe zonjën Edlira Cimb, drejtore e kabinetit të kryetarit të KLP-së. Edhe një herë ju uroj si staf mirëseardhjen në komisionin tonë!

Në fakt, ky raportim i parë i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në Komisionin e Ligjeve është detyrim që buron nga neni 149/a, pika 1, germa “dh” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe e nenit 181 të ligjit nr.115 të vitit 2016 për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ku thuhet se Këshilli i Lartë i Prokurorisë raporton para Kuvendit për gjendjen e sistemit gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, jo më pak se 1 herë në vit dhe raporti përshkruan veprimtarinë e Këshillit, të komisioneve tij, si dhe përmban rekomandimet për përmirësimet e nevojshme.

Meqenëse ky është raportimi i parë që Këshilli bën në Komisionin e Ligjeve, duke marrë në konsideratë edhe faktin se kemi të bëjmë me një organ kushtetues të sapokrijuar me vendim të Kuvendit, sipas asaj që ne kemi kaluar në komisionin tonë, ky Këshill është krijuar në muajin dhjetor të vitit 2018 dhe raportimi i sotëm përmbledh periudhën dhjetor 2018-korrik

2019, jo periudhën e plotë për vitin 2019, sepse kjo periudhë raportimi do të bëhet vitin tjetër, sipas ligjit për të gjitha institucionet kushtetuese të krijuara me ligj, që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit të Ligjeve dhe për të cilat Kuvendi del me rezolutë. Pra, sot do të kemi seancë dëgjimore, në përfundim të së cilës do të ketë një raport për Kryetarin e Kuvendit dhe kolegët deputetë, por që nuk do të ketë rezolutë, pasi rezoluta do të jetë vitin tjetër.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka sjellë në Kuvendin e Shqipërisë një raport të detajuar, material që u është vënë në dispozicion deputetëve, si edhe një memo të përgatitur nga Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit të Shqipërisë, të cilin e keni mbi tavolinë, por për më shumë dua t'ia kaloj fjalën zotit Ibrahim, kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të bërë një raportim para kolegëve të komisionit, medieve dhe opinionit publik. Pastaj kalojmë te diskutimet dhe pyetjet e kolegëve, sipas Rregullores së Kuvendit.

Zoti Ibrahim, fjala është për ju.

Po, zoti Braho, për procedurë.

Spartak Braho- Nuk e kuptova pse nuk do të ketë rezolutë. Unë mendoj se duhet të ketë një rezolutë, sepse këtu raporton struktura më e lartë e organizimit të prokurorisë, e cila ka një aktivitet të gjerë gjatë gjithë këtij viti. Vitin tjetër ne mund të bëjmë një rezolutë tjetër, por nuk e kuptoj pse të mos ketë për këtë vit një rezolutë. Ndoshta e kam kuptuar gabim, por, ju lutem, ma shpjegoni arsyen!

Ulsi Manja- Po, zoti Braho, jua shpjegoj unë.

Rezolutat që miraton Kuvendi i Shqipërisë janë për aktivitetin 1-vjeçar të çdo institucioni kushtetues dhe organi të pavarur. Ky është një raportim periodik dhe, duke iu referuar nenit 181 të ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pika 5, thotë: “Këshilli raporton në çdo rast tjetër që e vlerëson të nevojshme ose me kërkesë të Kuvendit”. Zoti Ibrahim është sot këtu me kërkesën e kryetarit të Komisionit të Ligjeve dhe komisionit që unë drejtoj për të raportuar për këtë periudhë të ndërmjetme deri në fund të vitit 2019. Natyrisht, për veprimtarinë e Këshillit për këtë periudhë 6-mujore do të informohet edhe Kuvendi i Shqipërisë nëpërmjet një raporti të veçantë, por për një institucion kushtetues ose institucion të krijuar me ligj nuk del rezolutë nga Kuvendi 2 herë në vit. Për këtë institucion do të dalim me rezolutë në periudhën e raportimit tjetër, e cila do të jetë brenda muajit maj të vitit 2020, ku do të kemi një rezolutë që do t'i drejtohet Kuvendit, ku edhe zoti Ibrahim, sipas Rregullores së Kuvendit, do të vijë të raportojë në seancë plenare. Kjo është arsyeja që sot jemi në një seancë dëgjimore dhe nuk do të kemi një rezolutë të miratuar nga Kuvendi.

Spartak Braho- Më fal, kryetar, por Këshilli raporton për periudhën dhjetor 2018 dhe po i afrohem dhjetorit 2019, që do të thotë se edhe një muaj plotësohet viti.

Ulsi Manja- Po, por ky muaj ndryshon dy vjet zoti Braho, nga viti 2019 në vitin 2020. Zoti Ibrahim, mund të vazhdoni.

Gent Ibrahim- Faleminderit, zoti kryetar!

Përsëritet të gjithë anëtarëve të Komisionit të Ligjeve!

Sot jemi këtu për të raportuar para Komisionit të Ligjeve për ecurinë e punës së Këshillit të Lartë të prokurorisë për periudhën 6-mujore, dhjetor 2018-korrik 2019. Saktësisht, nesër Këshilli mbush 10 muaj plot në detyrë, të cilat kanë qenë muaj intensivë, të cilët mund të karakterizohen me një fjali të vetme, duke thënë që gjatë kësaj periudhe ne kemi punuar për të krijuar institucionin, por edhe për t'iu përgjigjur detyrimeve ligjore, të cilat kanë edhe afate. Kjo i ka dhënë një dozë vështirësie ekstra punës së Këshillit, duke pasur parasysh se shumë prej detyrimeve tona të rëndësishme, që kanë qenë edhe në vëmendjen e publikut, si: procedurat për ngritjen e prokurorisë së posaçme dhe ato të përzgjedhjes së kandidatëve për prokurorë të Përgjithshëm kemi qenë të detyruar t'i zhvillojmë në kushtet e mungesës së një mbështetjeje të plotë administrative. Sidoqoftë, nuk besoj se ka munguar ndonjë gjë, në kuptimin e kryerjes së detyrimeve.

Thjesht për kujtesë dua të numëroj në mënyrë të përmbledhur detyrat e Këshillit që burojnë nga Kushtetuta dhe ligji:

Ne jemi organi përgjegjës për emërimin e prokurorëve, për vlerësimin e performancës së tyre dhe për menaxhimin e karrierës së prokurorëve. Pra, të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me ngritjet në detyrë dhe me transferimet janë kompetencë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë;

Ne jemi organ disiplinor për prokurorët e Republikës, që do të thotë se marrim vendimet përfundimtare në përfundim të një procesi hetimi, që nuk kryhet nga ne, dhe veprojmë si gjykatë në rastet e shkeljeve të prezumuara disiplinore nga ana e prokurorëve;

Ne jemi organi që i propozojmë Kuvendit kandidatët për prokurorë të Përgjithshëm, në mënyrë që ky i fundit të ushtrojë të drejtën e tij për ta zgjedhur përfundimisht Prokurorin e Përgjithshëm;

Ne miratojmë dhe mbikëqyrim zbatimin e rregullave të etikës në radhët e sistemit të prokurorisë;

Ne administrojmë vetëm buxhetin tonë si Këshill dhe nuk menaxhojmë buxhetin e sistemit të prokurorisë;

Ne kemi për detyrë të informojmë publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit të prokurorisë sa u takon burimeve njerëzore në këtë sistem. Ky është një saktësim i rëndësishëm që duhet bërë, sepse gjuha e ligjit shpeshherë duket sikur tregon se Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të raportojë edhe për gjendjen e punës në sistemin e prokurorisë, pra për nivelin e efikasitetit të hetimeve, për numrin e dosjeve e kështu me radhë, por nuk është kështu, sepse për këto çështje raporton Prokurori i Përgjithshëm. Ne raportojmë vetëm për gjendjen e personelit prokurorial dhe funksione të tjera, që ushtrohen nga ligji.

Dua të ndalem shkurtimisht te detyrat tona më të rëndësishme në kuadër të këtij spektri detyrash që na ka ngarkuar ligji, duke e filluar me procesin e krijimit të Prokurorisë së Posaçme. Dua të theksoj se ne e kemi hapur garën për zgjedhjen e kandidatëve për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme që në datën 7 janar dhe, po të bëni një llogari të vogël, është 2 javë nga dita kur ne u ulëm për herë të parë rreth tryezës si anëtarë të KLP-së. Kjo demonstroi vullnetin tonë dhe prirjen për të qenë sa më efikasë dhe më të shpejtë në kryerjen e kësaj detyre. Natyrisht që mua më duket e çuditshme që sot ne ende nuk e kemi Prokurorinë e Posaçme, por, siç e dini, këto janë procese të përbëra, ku ne mund të ecim aq sa mundemi, sepse ecuria e mëtejshme në proces varet edhe nga ecuria e procesit të vetingut, ku ligji e thotë qartë se çdo prokuror që të emërohet në prokurorinë e posaçme duhet të ketë kaluar vetingun me vendim të formës së prerë. Ne sot jemi në situatën ku kemi identifikuar dhe përzgjedhur 15 kandidatë, të cilët, sipas nesh, plotësojnë kriteret profesionale për të qenë prokurorë në Prokurorinë e Posaçme, por që duhet të marrin vulën e institucioneve të vetingut. Deri në këtë moment, vetëm 8 prej tyre kanë kaluar përmes këtij filtri. Kështu që Këshilli duhet të gjykojë se cili është momenti më i përshtatshëm për ta filluar funksionimin e Prokurorisë së Posaçme, duke pasur parasysh edhe nevojën që në këtë institucion të ri, duke parë pritshmëritë që janë shumë të mëdha, të shërbejë një numër prokurorësh, që është në gjendje të përballojë ngarkesën e punës.

Për sa u takon burimeve njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, ne jemi ende te plotësimi i personelit, sepse ju kujtoj që buxheti i KLP-së është aktivizuar vetëm në muajin qershor. Është e vërtetë që institucioni ynë është krijuar në dhjetor të vitit 2018, por buxheti ynë është aktivizuar në qershor dhe ne vetëm në atë fazë kemi qenë në gjendje të fillojmë procesin e rekrutimeve, i cili kryhet sipas procedurave të ligjit të shërbimit civil, që kërkon një kohë të caktuar. Kjo është arsyeja e parë pse personeli administrativ në mbështetjet të punëve të Këshillit është ende i paplotësuar dhe arsyeja e dytë ka të bëjë me hapësirat tona fizike. Ne jemi mysafirë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Prokurorinë e Apelit të Tiranës, të cilët bujarisht na kanë vënë në dispozicion disa zyra në institucionet përkatëse dhe jemi në pritje të

lëvizjes në një godinë, e cila është e jashtëzakonshme sa u takon hapësirave dhe mundësive që ofron për organizimin efikas të punës brenda institucionit, por kjo ende nuk ka ndodhur dhe, në këto kushte ne nuk mund të vijojmë me rekrutimin e të gjithë personelit për arsyen e thjeshtë se nuk kemi ende ku t'i akomodojmë. Ne jemi përpjekur që ta zbusim problemin e mangësive në personelin administrativ përmes komandimit të disa prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Sot që flasim janë 6 prokurorë, të cilët vijnë nga shkallët e ndryshme të sistemit dhe janë komanduar si këshilltarë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kjo është një procedurë që e parashikon ligji për statusin e prokurorëve dhe gjyqtarëve, i cili parashikon se prokurorët deri në 5 vjet gjatë karrierës së tyre mund të shërbejnë pranë institucioneve të tilla, si: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Ministria e Drejtësisë e kështu me radhë.

Ne, gjithashtu, kemi qenë të përfshirë në një marrëdhënie intensive me Shkollën e Magjistraturës, ku po kuptojmë akoma më shumë që kjo është një marrëdhënie jetike për të mirën e sistemit. Shkolla e Magjistraturës është burimi i vetëm i kuadrove për sistemin, qoftë atë gjyqësor, qoftë atë prokurorial. Është thelbësore që Shkolla e Magjistraturës të formojë kuadër të tillë, që u përgjigjet nevojave reale të sistemit dhe të prodhojë një numër të caktuar kandidatësh për prokurorë dhe gjyqtarë, numër që mund t'u përgjigjet nevojave në rritje të sistemit për personel të ri. Kështu që marrëdhënia jonë me Shkollën e Magjistraturës ka qenë shumë intensive në marrjen e vendimeve për numrin e kandidatëve për studentë në Shkollën e Magjistraturës, sepse është vërtet shumë e rëndësishme që në këtë fazë kur vetingu po vepron dhe po gërryen në një farë mase përbërjen e sistemit, duke lënë jashtë tij një numër të konsiderueshëm, sepse janë rreth 44% e prokurorëve që deri tani kanë kaluar në filtrin e vetingut, të cilët janë ose të larguar nga sistemi me vendim përfundimtar, ose të pezulluar dhe në pritje të vendimit përfundimtar të institucioneve të vetingut. Shifra 44% është një shifër e konsiderueshme dhe që krijon probleme në sistem. Pa dyshim që ne nuk mund të paragjykojmë se të gjithë këta prokurorë, të cilët janë pezulluar nga shkalla e parë e vetingut, do të largohen nga sistemi me vendim përfundimtar, por kjo është një mundësi reale dhe ndikon në llogaritjen tona, që kanë të bëjnë me numrin e pranimeve në Shkollën e Magjistraturës.

Gjithashtu, gjatë gjithë kësaj kohe jemi marrë edhe me procedurën për zgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, në mënyrë që t'i qëndrojmë detyrimit tonë kushtetutës për t'ju servirur ju një listë me 3 kandidatë për Prokuror të Përgjithshëm, të cilët të jenë figura të shquara, që më pas të ushtrojnë funksionin e rëndësishëm të Prokurorit të Përgjithshëm, në kuadër të parashikimeve kushtetuese dhe ligjore. Ne këtë procedurë e kemi

filluar në mars të vitit 2019, pra pak më vonë se sa procedura për përzgjedhjen e kandidatëve për prokuror të posaçëm. Arsyeja ishte thjesht një teknikalitet ligjor, sepse, për sa i takon Prokurorisë së Posaçme, ne nuk kishim detyrimin që ta fillonim garën, pasi të kishim miratuar rregulloren për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes. Në rastin e Prokurorit të Përgjithshëm e kishim këtë detyrim, pra nuk mund ta fillonim garën para se të kishim miratuar një rregullore me kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen. Kjo e vonoi paksa nisjen e procedurave për përzgjedhjen e kandidatit për Prokuror të Përgjithshëm, të cilat filluan në mars dhe janë në vijim. Për momentin janë të stopuara për shkak të ankimit të njërit prej kandidatëve, për të cilin Këshilli arriti në përfundimin se nuk i plotëson kushtet e parashikuara nga ligji për të qenë Prokuror i Përgjithshëm i Republikës. Besoj se në ditët në vijim do të kemi përgjigjen nga gjykata dhe nga ky çast Këshilli do të jetë në gjendje që të procedojë shumë shpejt për të vlerësuar 3 kandidatët, që mbeten në listë dhe për t'jua servirur ju më pas brenda një afati sa më të shpejtë.

Gjatë këtij harku 6-mujor ne kemi zhvilluar 26 mbledhje plenare; është një ritëm i jashtëzakonshëm, në kuadrin e ligjeve të vjetra. Unë këtu mund të evokoj shpejtësinë me të cilën mblidhej ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë; ishte një gjë krejt tjetër nga kjo që po shikojmë sot me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe atë Prokurorisë. Është një dinamikë krejt tjetër dhe një produktivitet krejt tjetër nga ana e këtyre institucioneve dhe kjo është shenja e parë që institucionet reja të krijuara në kuadër të reformës janë me të vërtetë gjëra të reja, jo vetëm nga mënyra se si janë kompozuar, nga kompetencat, por edhe nga dinamika e tyre dhe aftësia për të prodhuar. Vetëm ne kemi marrë 160 vendime në këto 6 muaj që është vërtet një shifër impresionuese. Jam i bindur që shifrat janë në këto nivele edhe për sa i përket Këshillit të Lartë Gjyqësor, në mos më tepër, duke pasur parasysh që ata kanë një fushë veprimi më të madhe se tonën. Këto 160 vendime kanë pasur të bëjnë pak a shumë, me 2 drejtime kryesore. I pari, është rregullimi i veprimtarisë së Këshillit, i dyti, natyrisht, është edhe objekti kryesor i punës sonë: rregullimi i statusit të prokurorëve ose hartimi dhe miratimi i rregulloreve nënligjore. Për shembull, siç janë rregullorja për veprimtarinë jashtë funksionit të prokurorëve, rregullorja për caktimin e përkohshëm të prokurorëve, rregullorja për pagesat e prokurorëve jashtë orarit të punës, si edhe vendime individuale për statusin e prokurorëve të veçantë, që kanë të bëjnë me emërimin e magjistratëve të rinj, me nisjen e procedurës për Prokurorinë e Posaçme, me mbarimin e statusit të magjistratëve, kur dalin në pension apo kur japin dorëheqjen e kështu me radhë.

Tani që flasim, ne jemi në një punë intensive për të përmbyllur dy rregullore të tjera që, në fakt, janë jetike për punën e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, pra është një rregullore për lëvizjen paralele të prokurorëve. Sistemi i prokurorisë është një sistem ku kuadrot e tij, pra prokurorët, lëvizin herë pas here nga një zyrë në tjetrën. Kjo i shërben qoftë rigjallërimit të punës, qoftë shpërndarjes më të mirë të ngarkesës së punës, ndonjëherë edhe ndarjes së punës midis prokurorëve sipas aftësive të tyre individuale. Në këtë kuadër, lëvizja paralele është jetike për një sistem të gjallë, siç është sistemi i prokurorisë sot. Megjithatë, ne nuk jemi ende në gjendje të procedojmë për kryerjen e lëvizjeve paralele, sepse na mungon një rregullore, të cilën ligji e kërkon.

Gjithashtu, po punojmë edhe për një rregullore, për ngritjen në detyrë të prokurorëve. Ne kemi qenë të detyruar shpeshherë t'i plotësojmë vendet e drejtuesve të zyrave të prokurorisë përmes caktimeve të përkohshme. Ashtu siç e keni parasysh drejtuesit e zyrave të prokurorisë trajtohen me prioritet nga institucionet e vetë dhe disa prej tyre janë larguar nga sistemi ose janë pezulluar. Në këto kushte, kemi qenë të detyruar t'i plotësojmë këto vakanca me caktime të përkohshme. Në kushte normale pozicioni i drejtuesit të një zyre prokurorie plotësohet përmes një procedure të ngritjes në detyrë, e cila është kompetitive. Ne jemi në përfundim të rregullores përkatëse për këtë punë, gjë që do ta bëjë procesin e ngritjes në detyrë të drejtuesve të prokurorisë një proces po aq publik, po aq kompetitiv dhe po aq kërkuar sa procesi për ngritjen në detyrë të prokurorëve të posaçëm, i cili ka qenë në vëmendjen e publikut për shumë kohë, të cilin jam i bindur që edhe ju keni pasur mundësi ta ndiqni.

Disa nga çështjet, me të cilat ne jemi ballafaquar janë këto:

Së pari, çështja, që unë përmenda në njëfarë mënyre, e vakuumit në sistemin e drejtimit në zyrat e prokurorisë, që ka ardhur si rezultat i shkarkimit ose i pezullimit të drejtuesve. Edhe këtu kemi qenë të detyruar të veprojmë me procedurën e caktimit të përkohshëm, e cila na shqetëson edhe neve, sepse këto janë pozicione, të cilat ligji i konsideron pozicione karriere dhe për të cilat vetëm një procedurë kompetitive e ngritjes në detyrë pranohet dhe justifikohet, por, përkohësisht, në kushtet emergjencës, kemi qenë të detyruar të përdorim caktimin e përkohshëm. Ne jemi munduar ta kufizojmë diskrecionin tonë në caktimin e përkohshëm, duke i imponuar vetes disa rregulla përmes një rregulloreje për përcaktimin e përkohshëm. Diskrecioni i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i ligjshëm, nuk ka ndonjë blasfemi në këtë pikë, sidoqoftë diskrecioni është edhe burim i arbitraritetit. Në këto kushte, ne me vetëdije e kemi kufizuar këtë diskrecion, duke i imponuar vetes rregulla përmes rregullores për përcaktimin e përkohshëm, e cila parashikon që kandidatët për t'u caktuar përkohësisht si

drejtues në zyrat e prokurorive duhet të kenë vlerësime pozitive për të shkuarën, duhet të kenë një eksperiencë pune X, duhet të vijnë nga brenda asaj zyre, ku ata caktohen përkohësisht, pra kemi vënë disa kriterë objektive, të cilat shpresojmë se do të na çojnë drejt zgjidhjeve të duhura, qofshin këto edhe zgjidhje provizore.

Sfida tjetër ka qenë nisja dhe ecuria e krijimit të Prokurorisë së Posaçme, jemi afër fundit. Ky proces, ashtu siç ju thashë është vonuar për shkak të procedurave të , të cilat për nga natyra janë të thella dhe të zgjatura.

Një tjetër sfidë, me të cilin jemi ballafaquar, ka qenë caktimi i numrit të magjistratëve, që do të pranohen në Shkollën e Magjistraturës. Ju me të drejtë mund të thoni se çfarë vështirësie ka këtu?! Ju e dini çfarë hapësirash krijohen në sistem përmes vetingut; mund ta parashikoni në njëfarë mase ecurinë e këtij procesi. Tashmë, kemi një kampion të respektueshëm, në kuptimin që një numër i caktuar prokurorësh kanë kaluar nëpër veting dhe kemi parë se në cilin nivel vepron vetingu. Domethënë, sa përqind e tyre pritet t'i lërë jashtë dhe ne me një lloj sigurie mund të parashikojmë, por ky është një ekuacion me dy të panjohura. E panjohura e parë është kjo, pra sa dhe si do të veprojë vetingu ndonëse për këtë e kemi një indikacion të besueshëm. E panjohura e dytë është kapaciteti i Shkollës së Magjistraturës, e cila mund të trajtojë vetëm një numër të kufizuar studentësh. Kështu që na është dashur të gjejmë një zgjidhje të ekuilibruar, e cila për vitin e kaluar ka qenë numri 25. Pra, ne dhe Shkolla e Magjistraturës kemi rënë dakord që kjo e fundit të pranojë jo më shumë se 25 kandidatë për prokurorë. Nevoja është për më shumë, por kemi ardhur në këtë shifër për shkak të kapaciteteve të Shkollës së Magjistraturës, që janë ato që janë, qoftë për sa i përket hapësirave. edhe pse kjo çështje ka marrë një zgjidhje, Shkolla e Magjistraturës ndryshe nga ne, tashmë ka shkuar te poli i drejtësisë, te godina e re që është vënë në dispozicion të 3 institucioneve të drejtësisë, sidoqoftë ngelet kapaciteti për sa u përket pedagogëve, të cilët janë ata që janë.

Për herë të parë ne e kemi eksperimentuar procedurën e vetingut për studentët në Shkollën e Magjistraturës dhe për ata që e mbarojnë Shkollën e Magjistraturës, sepse ndoshta për publikun nuk është e ditur, por, përveç këtij vetingu të madh që zhvillohet me gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, një miniveting zhvillohet nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për shumë funksionarë tjerë ose për kandidatë për funksionarë. Në rastin tonë ata, që janë kandidatë për të hyrë në Shkollën e Magjistraturës, pasi e kanë fituar provimin për të hyrë atje, i nënshtrohen këtij minivetingu, i cili nuk është kaq mini, por unë po e quaj mini për ta dalluar nga vetingu që zhvillohet nga institucionet kushtetuese të vetingut. Një veting ushtrohet edhe për studentët e Shkollës së Magjistraturës,

pasi e kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, përpara se të nisin karrierën e tyre si prokurorë. Çdo kandidat për një pozicion karriere i nënshtrohet një vetingu, i cili konsiston në verifikime që ne i kryejmë në institucionet e ndryshme të shtetit si: në tatime, dogana, shërbimin e inteligjencës, polici, prokurori, Inspektorati i Deklarimit të Pasurive e kështu me radhë. Ne vjelim një informacion të madh për secilin prej tyre dhe në përfundim të analizimit të këtij informacioni, dalim me një vendim, që ne e quajmë vendim për verifikimin e plotësimit të kushteve, nëse X apo Y kandidatë për studentë në Shkollën e Magjistraturës, do të lejohen të zhvillojnë studimin në Shkollën e Magjistraturës, apo jo? Pra, filtri i parë, garancia e parë për integritetin e magjistratëve të ardhshëm fillon sot, ku ne marrim një vendim për verifikimin e figurës së tyre, përpara se ata të ulem në bankat e Shkollës së Magjistraturës. Pra, vijon me një procedurë tjetër, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës dhe sa herë që prokurorët në detyrë kandidojnë për një pozicion karriere. E gjitha kjo vjen krahas procesit të zakonshëm të deklarimit dhe të kontrollit të pasurive, i cili ushtrohet për të gjithë funksionarët publik. Pra, filtrat dhe garancitë, që ne zbatojmë në ushtrim të kompetencave tona, në zbatim të ligjeve të reja të reformës, janë me të vërtetë impresionuese.

Një tjetër sfidë ka qenë ngritja e strukturës për të garantuar bashkëpunimin me organet e vetingut. Ashtu siç e dini, organet e vetingut shikojnë te magjistratët 3 gjëra: shikojnë pasurinë e tyre, integritetin e tyre dhe aftësitë e tyre profesionale ndër vite. Për këtë të tretën i ndihmojmë ne. Kjo nuk është një punë e thjeshtë, ashtu siç mund ta imagjinoni, kërkon kapacitete administrative, të cilat ne nuk i kishim në momentin e parë, ishte një punë që në atë çast kryhej nga Prokurori i Përgjithshëm dhe kjo detyrë u delegua te Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkë me disa nga kapacitetet administrative, që përdorte Prokurori i Përgjithshëm për ta kryer këtë punë. Në këtë kuadër, bëmë komandimin e 6 prokurorëve pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Këta janë njerëzit që nën drejtimin e komisionit tonë të vlerësimit, drejtuar nga zoti Balla, i cili ndodhet në krahun tim, bëjnë vlerësimin e anës profesionale të prokurorëve. Në këtë mënyrë ndihmojmë organet e vetingut për të kryer një nga tre komponentët e vlerësimit që ata bëjnë për prokurorët në detyrë.

Një sfidë tjetër ka qenë edhe ngritja e komisioneve pranë Këshillit, në kuptimin që na është dashur të gjejmë një kompozim të këtyre komisioneve, i cili, pa dyshim, reflekton kompozimin e këshillit në tërësi, por, gjithashtu, mban parasysh edhe aftësitë individuale të anëtarëve të këshillit dhe historitë e tyre profesionale. Besoj se ia kemi dalë kësaj duke krijuar disa komisione, të cilat janë funksionale për sa i takon kombinimit të aftësive, por edhe të aftësisë së bashkëpunimit të tyre me njëri-tjetrin dhe për të qenë produktivë.

Puna nëpërmjet komisioneve është filtri i parë për çdo produkt të këshillit. Pra, çdo projektvendim që vjen në Këshill vjen, së pari, si rezultat i punës së komisioneve. Këtu jemi në një fazë rakordimi, sepse disa vendime të Këshillit nuk janë 100% në fushën e kompetencës së këtyre komisioneve dhe ndonjëherë lindin pikëpyetje se kush duhet ta paraqesë këtë projektvendim, kush duhet ta trajtojë këtë çështje. Sidoqoftë, ne kemi qenë në gjendje që t'u japim një zgjidhje të arsyeshme edhe këtyre problemeve.

Sfidë mbetet edhe ndihma administrative për komisionet. Anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë deri para një muaji i kanë bërë vetë të gjitha punët: punët kërkimore, punët administrative, punën hartuese të dokumentacionit dhe, natyrisht, në fund fare detyrën ligjore të miratimit të këtyre akteve.

Dua të përmend këtu procedurën për përzgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm, si një proces, i cili, gjithashtu, është në fazën finale. Nëse procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme është pezulluar për shkak të ecurisë së punës në organet e vetë, procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për prokuror të Përgjithshëm është pezulluar për shkak të ankimit të njërit prej kandidatëve pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Por ne do të jemi shumë shpejt gati për t'i finalizuar këto dy procese të rëndësishme.

Meqenëse është hera e parë që raportojmë para një komisioni, jo vetëm si këshill, por edhe unë personalisht, në këto kushte, nuk e di se deri në çfarë niveli detajesh duhet të shkoj. Në qoftë se këto që thashë i gjykoni të mjaftueshme, po ndalem këtu, duke ju falënderuar për vëmendjen!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim, informacioni i dhënë në këtë raportim gjashtëmuor të aktivitetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është më se i mjaftueshëm, po të kemi parasysh faktin se është një institucion i ri, pra i krijuar rishtazi!

Fillimisht fjalën e ka zonja Bushka dhe pastaj do ta marrin kolegët e tjerë për pyetje.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti Ibrahim, përfaqësues i institucionit, mirë se vini në komision!

Faleminderit për prezantimin tuaj në këtë raportim!

Duke pasur parasysh që Këshilli i Lartë i Prokurorisë është krijuar më 19 nëntor të vitit 2018 dhe, po t'i referohemi ligjit, duhej të kishit raportuar vetëm për vitin e kaluar, e vlerësoj faktin që dhatë një ekspozë të punës suaj edhe për muajt e vitit 2019, sepse Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si një nga institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë është me interes të dëgjohet dhe të raportojë, në fakt, jo vetëm për komisionin, por edhe për dobinë publike, pra për interesin publik!

Unë nuk dua të bie në përsëritje të shpjegimeve që dha zoti Ibrahim, sepse janë edhe në raportin që kolegët e kanë përpara, por do të ndalem vetëm në dy-tri çështje, që i çmoj të rëndësishme, dhe do të bëj tri pyetje.

Së pari, dua të them se puna e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ka qenë objekt i analizës dhe i monitorimit edhe nga Bashkimi Europian, nga strukturat përkatëse, në vijim të procesit të integritetit në Bashkimin Europian. Në progresraport është vlerësuar puna që ka kryer Këshilli i Lartë i Prokurorisë (bëhet fjalë për progresraportin e vitit 2019) dhe me fokus të veçantë janë dhënë rekomandime, ku ngelet përmbushja e detyrave thelbësore me fokus kryesor shpeshhtësinë e punës që bën Këshilli për sa i takon procesit të vetingut dhe, sigurisht, për nxjerrjen e të gjitha akteve rregullatore që nxjerr Këshilli për të ndikuar në ngritjen sa më parë të organeve të tjera të drejtësisë, që, gjithashtu, janë të reja, siç janë Prokuroria e Posaçme ose emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm. Në fakt, zoti Ibrahim e shpjegoi se ku jemi me këto faza, ndaj nuk do të doja të ndalesha këtu.

Do të ndalem pak te raportet e kryera për aftësitë profesionale të prokurorëve. Keni kryer deri tani 33 raporte. E kuptojmë dhe e marrim në konsideratë faktin se Këshilli është një institucion i ri dhe ka pasur vështirësi për ngritjen e kapaciteteve të tij menaxheriale dhe të burimeve njerëzore, por dua të kuptoj se nga cila periudhë kanë filluar të kryhen këto 33 raporte dhe deri kur kanë mbaruar? Sa është, në njëfarë mënyre, koha që merr në dispozicion kryerja e një raporti, duke marrë në konsideratë faktin se nga ky raport i Këshillit të Lartë të Prokurorisë ndërvaret edhe procesi i vetingut për prokurorin përkatës?

Së dyti, lidhur me aftësitë profesionale, që janë në fokusin e punës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për prokurorët (sigurisht, e thatë me shumë të drejtë se nuk është një punë e lehtë, por është një punë edhe shkencore që kuptohet në bazë të kriterëve se sa arrihet aftësia profesionale e një profesionisti), kemi një shqetësim që në komision vijnë herë pas here ankesa... Besoj se të gjithë kolegët këtu do të mbështesin. Publiku nuk e ndan dot vijën ndërmjet pushtetit gjyqësor, pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ. Pra, publiku, kur nuk gjen dot zgjidhjet përkatëse, është i orientuar me dëshirën për t'i zgjidhur gjërat, duke i shprehur pakënaqësitë dhe ankesat e tij tek institucionet ku e çmon vetë të arsyeshme. Sakaq, ne kemi ankesa që vijnë këtu ose referohen pranë organit tuaj për punonjës të sistemit të prokurorisë. A merren këto ankesa në konsideratë gjatë vlerësimit të aftësive profesionale në punën tuaj në kuadër të procesit ndihmës që ju bëni për vetingun dhe si trajtohen?

Në lidhje po me këtë çështje, me të drejtë ju thatë se nuk keni më kompetenca hetimi për shkeljet disiplinore të pretenduara për prokurorët. Por nëse ka ankesa dhe vijnë te ju për

shkelje disiplinore, sepse sot nuk e kemi ngritur ende Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, si veproni, në mungesë të këtij vakuumi ligjor, le të themi, dhe atij institucional (që nuk është ngritur ende Inspektorati i Lartë i Drejtësisë), duke iu referuar të drejtës suaj si institucion për të nxjerrë edhe akte rregullative për çështje të caktuara?

Pyetja tjetër ka të bëjë me aftësitë tuaja buxhetore. Me të drejtë ju thatë se edhe çështja e ngritjes së strukturës ndikon në performancën e institucionit, sepse puna bëhet me stafe. Pra, nëse stafi nuk është i kompletuar, sigurisht kjo gjë ndikon në punë. Ju keni kërkuar për buxhetin 2020-2022 një shtesë prej 18 punonjësish, ndërkohë që rezulton se deri në këto momente ose të paktën deri në momentin kur keni paraqitur raportin, që të jem e saktë, keni plotësuar nga struktura aktuale, tashmë e miratuar, rreth 23% të stafit. Arsytet i shpjeguat, por dua thjesht një sqarim: kur do t'i plotësoni nevojat e strukturës aktuale, sepse ju e dini që në buxhet kushtet kryesore kanë të bëjnë me faktin që, kur kërkohet shtesë, duhet të jetë ezauruar ajo që është dhënë me një vendim të mëparshëm?

E fundit, në korrik ne miratuam disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në këto shtesa dhe ndryshime më e rëndësishmja për sa u përket nevojave që ka pasur si Këshilli i Lartë Gjyqësor, ashtu edhe ai i Prokurorisë, ka të bëjë edhe me nenin 25 “Dispozita kalimtare”, që parashikon rregullat për procedurat e transferimit paralel dhe të ngritjes në detyrë të magjistratëve që kandidojnë gjatë kësaj periudhe. Ky nen parashikon që qoftë Këshilli i Lartë i Prokurorisë, qoftë Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të nxjerrë një rregullore për të kryer zbatimin efektiv të kësaj dispozite, e cila ndihmon edhe në plotësimin e atyre vakancave që janë krijuar qoftë nga vetingu, qoftë nga pezullimet apo edhe nga dorëheqjet e mundshme. Deri ku jeni në këtë fazë dhe a ju ndihmon kjo dispozitë në efektivitetin e punës? Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Meqenëse u bënë disa pyetje nga relatorja, do të desha, zoti Ibrahim, të ishit i qartë në përgjigjet që do të jepni, pasi janë gjëra shumë teknike dhe ndoshta nuk kapen siç duhet nga opinioni publik, flas qoftë për pyetjet e koleges Bushka, qoftë për pyetjet që mund të kenë kolegët e tjerë. Kam përshtypjen që interesi publik është tjetër gjë sot në raportimin tuaj në Komisionin e Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të themi se, përtej gjërave të karakterit teknik dhe që lidhen me ngritjen e institucionit, opinioni publik sot është i interesuar për të ditur kur do ta kemi SPAK-un, kur do të kemi Prokuror të Përgjithshëm, cila është gjendja e sistemit të prokurorisë sot dhe cili është

roli i Këshillit të Lartë të Prokurorisë në këtë fazë, kur kemi shumë prokurorë ose kemi shumë ankesa, apo shumë kritika për sistemin, për sjelljen e prokurorëve të caktuar e kështu me radhë.

Pra, do të desha që t'u përgjigjeshit pyetjeve të koleges Bushka, e cila do të bëjë edhe raportin, në fakt, për kolegët e mi të komisionit, por kam një sugjerim edhe për kolegët: të keni pyetje që përçojnë mesazh tek opinioni publik. Jeni një institucion i ri, keni bërë goxha punë, keni marrë rreth 160 vendime në dhjetë muaj dhe, po të marrim numrin e vendimeve që keni marrë në raport me muajt e krijimit, i bie të keni marrë gati dy vendime në muaj. Por problemi është që nga kjo tryezë sot, nga ky komision, do të duhet të përçojmë mesazhin e duhur në raportimin që ju bëni.

Po jua kaloj fjalën për përgjigjet ndaj pyetjeve të koleges Bushka.

Gent Ibrahimi – E kuptoj shqetësimin tuaj. Pa dyshim, ato janë pyetje teknike, të paktën disa prej tyre, por kanë të bëjnë edhe me thelbin e punës sonë, i cili sjell këto produkte të mëdha.

Jam i bindur që edhe përgjigjet ndaj atyre pyetjeve, që mund të duken teknike, janë të tilla që mund të japin informacion për ato çështje që publiku i percepton si jetike.

Po i marr me radhë pyetjet e zonjës Bushka.

Për sa i përket pyetjes së parë lidhur me numrin e raporteve që ne kemi prodhuar në ndihmë të organeve të vetingut, pra për vlerësimin e aspektit profesional të prokurorëve, të cilët i nënshtrohen vetingut, numri është ai që thatë ju, 33 raporte.

Lidhur me pyetjen se sa është koha mesatare që kërkohet për përgatitjen e këtyre raporteve, nëse mund t'ia kaloj fjalën zotit Balla, i cili është marrë më afër me këtë çështje...

Ulsi Manja – Po, zoti Balla.

Alfred Balla – Faleminderit, zoti kryetar!

E nderuar zonja Bushka,

Të nderuar anëtarë,

Siç e thatë edhe ju, ne jemi pjesë e sistemit të kontrollit të rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, pasi përpilojmë raportin e veprimtarisë profesionale të prokurorëve.

Vetëm në muajin shkurt, ne arritëm të atashojmë gjashtë prokurorë pranë Këshillit, të cilit i kemi të komanduar, pasi kërkohet procedura e nevojshme.

Mesatarisht arrijmë të prodhojmë pesë-gjashtë raporte në muaj. Kuptohet që një prokuror i atashuar pranë nesh mund të prodhojë një raport, i cili është voluminoz dhe përfshin kontrollin e hollësishëm të tetë çështjeve, tri i zgjedhin prokurorët dhe pesë zgjidhen me një short të rastësishëm, por, gjithashtu, kontrollojmë çdo ankesë dhe çdo procedim disiplinor (që

mund të ketë pasur për prokurorët) që vjen nga çdo qytetar ose prokurori e Republikës. Pra, është një punë voluminoze, por sado që kemi qenë në kushtet e mungesës së administratës, kemi punuar vetë, siç e tha edhe zoti Ibrahim. Një gjë jua them me bindje: nuk jemi bërë pengesë dhe jemi duke u rakorduar shumë mirë me organet e vetingut. Pra, mbajmë një marrëdhënie direkte dhe, e përsëris, nuk jemi ne pengesë për përfundimin e këtij kontrolli.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim – Është e vërtetë që ne na ndodh shumë rrallë të kemi një kërkesë urgjence nga organet e vetingut, ku të na thuhet se, nisur nga fakti që ju po e vononi vlerësimin e komponentit profesional të prokurorit, kjo gjë po pengon punën tonë këtu. Në fakt, e kundërta është e vërtetë, që ne nuk po arrijmë të ecim me detyrat tona kryesore për shkak të prirjes së procesit të vetingut për të qenë i zgjatur. Padyshim që ne kemi të gjithë mirëkuptimin e duhur për këtë punë. Procesi i vetingut është një proces unikal që nuk është parë ndonjëherë në këtë vend, është i thellë, i gjerë, e mirëkuptojmë nevojën e tij për kohë, por objektivisht koha që ata marrin është arsyeja e parë dhe e fundit, pse ne sot ende nuk kemi Prokurorinë e Posaçme dhe listën me kandidatë për Prokurorin e Përgjithshëm.

Në lidhje me pyetjen për trajtimin e ankesave, dua të them se është me të vërtetë një pyetje pikante, një problem, me të cilin ballafaqohemi çdo ditë. Te ne vijnë ankesa nga njerëzit. Siç e thatë ju, qytetarët nuk janë në gjendje dhe as nuk janë të predispozuar të kuptojnë me saktësi se ku duhet ta çojnë ankesën për një gjë të caktuar dhe ku për një gjë tjetër, aq më tepër që kjo mungesë kuptimi është e mirëkuptuar në kushtin e rikompozimit të sistemit të drejtësisë, të rindarjes së kompetencave midis institucioneve të ndryshme. Unë e them shpeshherë, sa herë që kam mundësi se Këshilli i Lartë i Prokurorisë në thelb është një zyrë e burimeve njerëzore për sistemin e prokurorisë. E thënë thjeshtë do të thotë që ne jemi përgjegjës për të përcaktuar numrin e kandidatëve për prokurorë që hyjnë në sistem, jemi përgjegjës për t'i emëruar ata, pasi bëjmë vetingun e integritetit të figurës së tyre, jemi përgjegjës për ecurinë në karrierë të prokurorëve dhe për disiplinimin e tyre, por edhe etika është një dimension tjetër i rëndësishëm i Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Sidomos në fushën e prokurorisë, ndarja e kompetencave është pak sa më e koklavitur në krahasim me fushën e gjyqësorit. Në fushën e gjyqësorit të gjitha letrat, me të drejtë kanë vetëm një adresë, që është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në fushën e prokurorisë letrat, shqetësimet dhe ankesat kanë të paktën 3 adresa, në varësi të natyrës së tyre. Këshilli i Lartë i Prokurorisë është destinacion, vetëm për ato

shqetësime që kanë të bëjnë me sjelljen e prokurorëve, me mungesën e profesionalizmit apo të etikës. Ne jemi adresa, destinacioni i duhur. Për çështje të tjera që kanë të bëjnë me buxhetin, me organizimin e punës, me thelbin e hetimit, këto duhet të shkojnë në drejtime të tjera. Ankesat e njerëzve kanë të bëjnë me të gjitha këto. Ne përpiqemi të kuptojmë se cila nga ato është e duhura për ne. Shpeshherë nuk është e vështirë të kuptosh se fjala është për sjelljen e prokurorit. Deri tani kemi qenë përpara një vështirësie të dyfishtë. Kemi vepruar në kushtet kur ligji nuk kishte një listë me shkeljet disiplinore të prokurorëve që t'i të mund të ballafaqojë letrën e publikut dhe të thoshe: “Kjo ankesë e këtij qytetari, me cilën nga këto shkelje korrespondon?”. Thjesht kjo listë mungonte për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që e rrëzoi nenin përkatës në ligjin “Për statusin”.

Vështirësia e dytë lidhet me faktin që nuk ishte dhe ende nuk është në funksion institucioni që heton këto ankesa, që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Vështirësia e dytë është paksa më e moderuar, sepse dispozitat tranzitore të ligjit parashikojnë që deri në çastin e ardhjes së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë hetimet e shkeljeve disiplinore të prezumuara të prokurorëve mund të bëhen nga Prokurori i Përgjithshëm. Ky i fundit deri para pak javësh kur hynë në fuqi amendamentet për ligjin “Për statusin”, thjesht nuk kishte se çfarë të hetonte, ndërsa tani ka se çfarë të hetojë, sepse tani ekziston lista me shkeljet disiplinore dhe Prokurori i Përgjithshëm mund të bëjë ballafaqimin e ankesave me shkeljen e pretenduar, por është një gjë e re. Ne ende nuk e kemi marrë deri tani nga Prokurori i Përgjithshëm, sepse ka qenë e pamundur një procedim formal për disiplinimin e një prokurori. Në këto kushte ne i trajtojmë ankesat për aq sa mundemi, ia përcjellim Prokurorit të Përgjithshëm. Ndonëse e kuptoni fare mirë se deri pak javësh Prokurori i Përgjithshëm nuk mund të bënte asgjë, por tani mund të bëjë diçka, mund të hetojë dhe mund t'i sjellë përpara Këshillit për Gjykim. Këtu ka një dyshim të vogël, disa prej anëtarëve të Këshillit mendojnë që dispozita tranzitore i jep Prokurorit të Përgjithshëm vetëm fuqinë për të hetuar, por jo për të nisur një procedim disiplinor. Unë i përkas një grupi tjetër brenda Këshillit që nuk mendojmë kështu. Ne mendojmë: “Po, Prokurori i Përgjithshëm pasi heton edhe mund të nisë procedimin disiplinor”. Megjithatë vetëm tani ne jemi në gjendje të bëjmë një trajtim më adekuat të ankesave të publikut.

Shumë shkurt, për sa i përket pyetjes për buxhetin, është e vërtetë se ne kemi vështirësi të shtuara, pasi na duhet të llogarisim nevojat buxhetore dhe për personel në kushtet kur ende nuk kemi provuar se si do të jetë jeta po ta kishim personelin e plotë. Është një llogaritje, e cila është pak sa teorike nga ana jonë, por mendoj se jemi në gjendje të kuptojmë

se çfarë na duhet, pavarësisht se ende nuk e kemi provuar se si është të punosh me kapacitet të plotë, pasi siç e thatë edhe ju, nuk mund të rekrutojmë të gjithë personelin që na është ngarkuar për shkak të procedurës së rekrutimit, por edhe për shkak të faktit se nuk kemi ku t'i akomodojmë deri në çastin kur do të lëvizim te godina e re e polit të drejtësisë.

Në lidhje me mundësitë e reja që na jep neni tranzitor në ligjin “Për statusin”, mund të them: po, tani ne jemi në gjendje, tani presim që për raste konkrete të marrim propozime për procedime të mirëfillta disiplinore nga Prokurori i Përgjithshëm.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Ibrahim!

Ka pyetje nga kolegët? Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia - Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të falënderoj kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për informacionin dhe për të gjithë transparencën që bëri edhe në materialin që na ka dërguar!

Në fakt, është ashtu siç tha kolegja Bushka, që vlerësime për këtë institucion vijnë jo vetëm nga progresraporti, por edhe nga perceptimi i qytetarëve.

Unë do të jem konkret në ato gjëra që i përmendi edhe kryetari Manja: sensibiliteti i opinionit publik ka të bëjë kryesisht me ngritjen e SPAK-ut dhe me zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm.

Ju na informuat se procedurën për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm e keni nisur që në muajin mars, nëse jam i saktë dhe janë përzgjedhur kandidaturat sipas kriterëve që ju keni vendosur. Ndërkohë jam i interesuar të pyes: a janë përcaktuar kriteret e pikëzimit brenda këtyre 3 prokurorëve, të cilët do të garojnë? Pasi vendimmarrja juaj është vendimmarrja kryesore, sepse ndodh që në parlament, pavarësisht se në Kushtetutë është parashikuar se duhen 140 deputetë, parlamenti mund të mos bjerë dakord dhe vendimmarrja juaj, bën që të zgjidhet ai që është renditur i pari në listën e përzgjedhjes. A e keni bërë publike, se cilat janë kriteret që do të saktësojnë zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm?

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Ibrahim!

Genti Ibrahim - Ju falënderoj për pyetjen zoti Qefalia!

Po, pa dyshim që ne kemi një rregullore, që përcakton kriteret përkundrejt me të cilat ne vlerësojmë kandidatët dhe procedurën që ndjekim për kryerjen e kësaj detyre edhe diapazonin e vlerësimit që ka në dispozicion secili nga anëtarët e Këshillit për të vlerësuar kandidatët. Kjo është rregullorja për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm, e cila është e botuar në Fletoren Zyrtare. Ajo që mund ta keni

dëgjuar edhe nga raportimi në medie është fakti se Këshilli nuk ka qenë në gjendje që në zbatim të kësaj rregulloreje të miratojë një metodologji akoma më konkrete që i orienton më në detaje anëtarët e Këshillit për vlerësimin e kandidatëve. Për t'ua dhënë më të thjeshtë përgjigjen, nëse rregullorja jonë thotë se secili nga anëtarët e Këshillit kur vlerëson kandidatët për aspektin e aftësisë profesionale, ka në dispozicion nga 1 deri në 5 pikë. Kjo metodologji, të cilën nuk e kemi miratuar ende, do t'i orientonte më tej kandidatët, duke u thënë: "Shikoni, brenda këtij kriteri të madh, mund të shikoni këtë nënkriter dhe për këtë mund të jepni deri në 2 pikë. Për nënkriterin tjetër mund të jepni 2 pikë dhe për nënkriterin tjetër deri në 1 pikë". Pra, është një përpjekje e mëtejshme për të orientuar anëtarët e Këshillit për t'i pikëzuar. Megjithatë, edhe në kushtet kur nuk kemi një metodologji si kjo që sapo shpjegova, por kemi thjesht rregulloren, ku çdo anëtar i Këshillit ka detyrimin të japë nga 1 deri në 5 pikë për kandidatin në varësi të kriterit, përsëri mund të veprojmë. Kuptohet që hapësira për diskrecion e anëtarit në kushtet kur pikëzimi do të bëhet vetë mbi bazën e rregullores është më e madhe. Unë do të kem më shumë diskrecion për të dhënë 1 ose 5 pikë pa shumë justifikim. Po të miratohet metodologjia do të më duhet të shpjegoj se këtë 5-ën që kam në dispozicion e ndava në këtë mënyrë: 2 për këtë, 2 për atë dhe 1 për këtë. Ne mund të bëjmë një pikëzim të ndershëm dhe profesional edhe në kushtet kur nuk e kemi metodologjinë. Kjo e fundit është një përpjekje e mëtejshme për të kufizuar diskrecionin tonë. Ne duket sikur nuk na pëlqen diskrecioni, por ai është një komoditet shumë i madh për vendimmarrësit. Por ne e kuptojmë që vëmendja dhe interesi i publikut për vendimmarrje tona janë kaq të mëdha sa që përpiqemi t'u tregojmë të gjithëve se po veprojmë në kushtet e një rregullimi, i cili vepron njëloj për të gjithë.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zoti Braho

Spartak Braho – Zoti Ibrahim, jo vetëm opinionin e gjerë, por të gjithë, ne dhe ndërkombëtarët i kanë të sytë te ju. Unë mund të flas vetëm për opinionin pozitiv që është krijuar për strukturën tuaj, për Këshillin e Lartë të Prokurorisë tuajin në mënyrë të posaçme. Por më bën përshtypje që në relacionin e Shërbimit të Monitorimit ka disa shifra që më bëjnë përshtypje jo të mirë. Për shembull, në raport citohet se stafi mbështetës është kompletuar në masën 23%.

E dyta, në këto kushte kjo nuk legjitimon kërkesat buxhetore për vitet 2020-2022 të KLP-së, pasi do të ketë edhe 18 vende të tjera shtesë. Këtu nuk është punë zyrash, por është punë e angazhimit tuaj më të mirë. Nuk i justifikoni se nuk keni zyra, apo ka pengesa, por duhet të tregoheni më të zhdërvjellët në këtë sens, sepse rrezikoni buxhetin për vitet

pasardhëse. Pyetja e përmbledhur është: këto shifrat që raporton Shërbimi i Monitorimit, a janë të sakta? Ka një pritshmëri të madhe për ngritjen e strukturës së SPAK-ut. Të gjithë e dimë se ju jeni në vështirësi, sepse jo çdo gjë varet nga ju në ngritjen e SPAK-ut. Nga 15 janë miratuar 8. Pse nuk filloni punën me 8? Që sot këtu në komision mund të na jepni një mesazh se edhe me 8 fillohet. SPAK-u duhet të fillojë urgjentisht.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Ibrahim.

Genti Ibrahim - Faleminderit, zoti Braho!

Për t'i dhënë një përgjigje koncize pyetjes suaj nëse konstatimi i Shërbimit të Monitorimit është i saktë, do të thosha: po, është i saktë, vetëm dua të shtoj 3 gjëra. Kjo shifër vlen deri në fund të muajit korrik. Nga korriku e këtej kemi ecur më shumë. Sot që flasim nuk kemi 23%, nuk jam në gjendje t'iu them sesa, sepse nuk ishim përgatitur për të raportuar, por është padyshim afër 50% -shit gjendja e personelit dhe deri në fund të vitit mund të jetë afër 80%-shit. Pra, vërejtja e tyre qëndron, por do të vijë duke u zbutur me kalimin e kohës. Unë edhe nga natyra si person nuk e kam problem të them po, e pranoj përgjegjësinë, por janë disa gjëra që janë objektive, zoti Braho. Paratë në llogarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë hyrë në qershor, pra objektivisht kjo është një vështirësi për të filluar procesin. Nuk mund të rekrutosh askënd nëse nuk je në gjendje që t'i lidhësh pagën dhe t'ia garantosh atë.

Çështja e godinës: sot jemi vërtetë në kushtet kur nuk mund të fusim në zyrë as edhe një person të vetëm. Është vërtetë limiti i hapësirës që na lejojnë zyrat që na ka vënë në dispozicion Prokuroria e Përgjithshme dhe anëtarët ndajnë zyrat dy e nga dy, kështu që ka ca vështirësi subjektive. Sidoqoftë, konstatimi qëndron. Unë mendoj se ky konstatim duhet të vijë duke u zbutur, sa i takon përgjegjësisë së këshillit, deri në fund të vitit. Në qoftë se tani jemi në nivelin rreth 50 të rekrutimeve, besoj se deri në fund të vitit do të jemi rreth 80 %.

Sa i takon çështjes së SPAK-ut...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Shameti!

Gent Ibrahim – Sa i takon çështjes së SPAK-ut, padyshim që shqetësimi është shumë legjitim. Tani që flasim, ne kemi tetë prokurorë, të cilët mund t'i emërojmë. Në çastin që i emërojmë, Prokuroria e Posaçme fillon. Kuptohet, ky vendim do të shoqërohet edhe me njëqind vendime të tjera, për të rregulluar pasojat e tij. Nuk dua t'ju fus shumë në detaje, por fare shkurt, në momentin që ne emërojmë këta tetë prokurorinë në SPAK, duhet të emërojmë edhe dymbëdhjetë prokurorë të tjerë, që mbeten në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, që nuk

janë anëtarë të SPAK-ut. Duhet të ndërpresim shumë caktime të përkohshme të prokurorëve, për të krijuar hapësira për këta të dymbëdhjetë. Pra, ka një mori veprimesh, në lidhje me të cilat jemi të përgatitur.

Ditën kur ne do të marrim vendimin për emërimin në SPAK të këtyre tetë ose më shumë prokurorëve, shpresoj, ne do të marrim edhe rreth pesëdhjetë vendime të tjera, për të akomoduar efektet anësore që do të krijojë ky vendim.

Në lidhje me faktin nëse mund të fillojë me tetë apo jo, ky do të jetë një gjykim i këshillit. Nuk do të desha ta paragjykoja, më mirëkuptoni, ju lutem, por këshilli duhet të mblihet dhe të thotë: po, ne sot e fillojmë Prokurorinë e Posaçme, me saq prokurorë sa kemi në dispozicion.

Personalisht, mendoj se ajo çka na mban, është më shumë një arsye praktike, e cila ka të bëjë me aftësinë e këtyre të tetëve për të përballuar valën e punës. Ne kemi bërë një llogari në lidhje me ngarkesën e tyre, dhe na ka rezultuar se nëse prokuroria fillon sot me tetë prokurorë, secili prej tyre do të ketë një ngarkesë prej pesëdhjetë e pesë çështjesh nën hetim, që është një ngarkesë e konsiderueshme, duke pasur parasysh se drejtuesi i prokurorisë do të duhet të zhvishet, të paktën për ca kohë, nga çdo lloj përgjegjësie hetimore, sepse e pret me të vërtetë një mal me punë administrative, mes të cilave në radhë të parë është ndërtimi i Policisë së Posaçme, i Byrosë Kombëtare të Hetimit, kështu që ngarkesa bëhet edhe më e madhe.

Pra, kjo është ajo gjëja që po na mban. Sidoqoftë, pavarësisht se nuk është vendimi im, dhe nuk dua ta bëj më gabimin e dhënies së datave, ngaqë e kam bërë disa herë në të kaluarën, unë mund t'ju premtoj se ne do të konkludojmë me të vërtetë shumë shpejt sa i takon Prokurorisë së Posaçme. Ne kuptojmë se nga krijimi i saj varet edhe fillimi i procedurave për Byronë Kombëtare të Hetimit, që do të jetë një proces i gjatë.

Po ju paralajmëroj juve dhe publikun me këtë rast, se procesi i krijimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit do të jetë një proces relativisht i gjatë, sepse do të marrë disa muaj kohë. natyrisht, ligji ka parashikuar dispozita transitorë, që prokurorët e Prokurorisë së Posaçme të mund të punojnë përmes oficerëve të policisë, që janë tashmë pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, pra përmes asaj administrate, por të gjitha këto duhet të zëvendësohen gradualisht, sepse ata që do të hyjnë në këtë institucion, do të hyjnë nëpërmjet kriterëve të reja shumë ekzigjente sa i takon profesionalitetit dhe integritetit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Fjalën e ka kërkuar zonja Hysi, për një pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Balla, ju lutem, nëse keni diçka për të shtuar.

Alfred Balla – Po, kam diçka për të shtuar në lidhje me sa tha zoti Ibrahim, për t'iu përgjigjur pyetjes së zotit Braho.

Është i vërtetë interesimi i publikut dhe i joni, në lidhje me krijimin e strukturës SPAK. Unë sjell këtu edhe mendimin e kolegëve. Këshilli është i ndarë, në kuptimin se një pjesë e këshilltarëve mendojnë nëse do të shkelet numri dhjetë, që vendos Kushtetuta, për fillimin e punës së SPAK-ut, apo do ta krijojmë edhe me tetë? Sot, në kushtet kur nuk është krijuar Gjykata Kushtetuese, ne nuk kemi një organ, prej të cilit të mund të marrim një mendim në lidhje me këtë problem. Megjithatë, të jeni të bindur se kur të krijojmë SPAK-un, ky do të jetë një debat i hapur mes anëtarëve të këshillit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Balla!

Në fakt, në përfundim të kësaj seance dëgjimore, patjetër që edhe Komisioni i Ligjeve do të dale me një raport në lidhje me konstatimet përkatëse, sepse në vlerësimin tim, ligji ka zgjidhje për të gjitha situatat. Kuadri rregullator i ligjeve të reja të reformës ka zgjidhur çdo lloj situatë, ndonëse ligjet, sado perfekte që të jenë, nuk mund t'i parashikojnë të gjitha, por edhe për këtë diskutim ka zgjidhje kushtetuese e ligjore.

Zonja Hysi, keni fjalën për pyetje.

Ju lutem, për efekt kohe të jemi sa më të saktë në pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do të vazhdoj atë që ju sapo theksuat.

Kam një pyetje, zoti Ibrahim, lidhur me marrëdhëniet midis KLP-së dhe organeve të vetingut. Ju thatë se Byroja Kombëtare e Hetimit do të marrë kohë, ndërkohë që Prokuroria e Posaçme ka ende kandidatë që janë në pritje të procesit të verifikimit. Cili është komunikimi midis institucionit që ju drejtoni dhe organeve të vetingut? A i vini në dispozicion në kohë të gjitha materialet që duhen për këta kandidatë? Si mund të inkurajohen këta organe, për t'i parë me përparësi edhe shtatë kandidatët e tjerë, të cilët janë ende në procesin e vlerësimit?

Pyetja e dytë ka të bëjë pikërisht me këtë që ju sapo thatë. Padyshim, ngritja e Byrosë Kombëtare të Hetimit do të marrë kohë, sepse ka një procedurë, po ndërkaq, besoj se nuk ka asnjë pengesë që brenda dy muajve nga ngritja e SPAK-ut, ju të keni bërë gati i gjithë procedurën, aktet nënligjore, rregulloret e të tjera. Pra, të mos pritet ai afati procedural e kushtetuese, që thuhet brenda dy muajve nga ngritja e këtyre, të ngrihet edhe Byroja Kombëtare e Hetimit.

Në ç'fazë jeni me përgatitjen e gjithë infrastrukturës nënligjore për Byronë Kombëtare të Hetimit?

Besoj se edhe këtu keni një asistencë shumë të madhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim – Faleminderit, zonja Hysi!

Në lidhje me mënyrën se si ne komunikojmë me organet e vetëgjyqësorisë, padyshim që është një komunikim formal, institucional. Ajo çka bëjmë ne, është që u dërgojmë atyre një listë me kandidatët që janë prioritarë për shkak të nevojave tona. Nevojat tona janë mundësia për të përzgjedhur kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm. Në fakt, siç e dini, tre prej kandidatëve vijnë nga sistemi i prokurorisë. Si të tillë, u nënshtrohen procesit të vetëgjyqësorisë, kështu që ne u dërgojmë një listë organeve të vetëgjyqësorisë për këta tre zonja dhe zotërinj. Po kështu edhe për kandidatët për Prokurorinë e Posaçme. E vërteta është se organet e vetëgjyqësorisë i kanë trajtuar me përparësi.

Natyrisht, ne nuk jemi kurrë të kënaqur me ritmin. Sa më shpejt, aq më mirë do të ishte, por ata kanë nevojat e tyre, kështu që jemi të detyruar të presim.

Sa i takon një praktike për të përshpejtuar ndërtimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, pyetja është shumë me vend. Ka një vështirësi në këtë pikë. Vështirësia qëndron në faktin që Këshilli i Lartë i prokurorisë nuk ka kompetenca në lidhje me Byronë Kombëtare të Hetimit. Kompetencat tona përfundojnë me emërimin e drejtuesit të SPAK-ut, dhe me emërimin e drejtuesit të BKH-së. Edhe në rastin e emërimit të drejtuesit të BKH-së, në thelb ne kemi një fuqi vetoje. Ne do të na paraqitet një kandidat, në lidhje me të cilin ne do të themi po ose jo. Pra, nuk është se kemi pushtet real në lidhje me këtë. Ideja e kushtetutëbërësve ka qenë që SPAK të jetë një organizëm i pavarur dhe i menaxhuar vetë së brendshmi.

Megjithatë, është e vërtetë ajo që thoni ju, se ndërkohë partnerët tanë po punojnë për hartimin e shumë akteve nënligjore, për të cilat edhe ne kemi ndihmuar. Kemi vënë në dispozicion të tyre gjithçka nga puna jonë, që është relevante për Byronë Kombëtare të Hetimit, kur ajo të krijohet. Për shembull, të gjitha procedurat tona të atij minivetëgjyqësorisë që përmenda, të gjitha aktet nënligjore, mbi të cilat ne e bazojmë këtë aktivitet, ua kemi vënë në dispozicion, kështu që ata do të mund ta fillojnë më shpejt nga ç'kemi filluar ne. Sidoqoftë, vështirësia mbetet.

Kemi vënë në dispozicion faqen tonë, për të rritur sensibilizimin e personave të interesuar, që kanë ndërmend të kandidojnë për në Byronë Kombëtare të Hetimit, por sidoqoftë,

procesi i krijimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit nuk është se ka një institucion përgjegjës, sepse qëllimi i legjislatorit ka qenë që SPAK të jetë i vetëqeverisur. Në këto kushte, ne bëjmë aq sa mundemi.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi e ka kërkuar fjalën për pyetje.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti Ibrahim, Në fakt, e kam lexuar raportin tuaj, të them të drejtën dy herë. Në fakt, për shkak të profesionit tuaj si profesor, e kam lexuar me kureshtje. Kjo është diçka që ju e kryeni shumë mirë, është merita juaj. Keni respektin tim maksimal, për shkak të zgjedhjes suaj në krye të këtij institucioni. Në fakt, ju e amortizoni mirë këtë pjesën politike, prandaj jeni personi i duhur për ta bërë këtë. Është merita jua personale.

Në seancën e mëparshme, javës që kaloi, Kryeministri përdori një epitete: “kap ç’të kapësh”, KÇK. A keni pasur ju ndonjë rast të tillë?

Kam edhe dy pyetje, të cilat do të doja t’i bëja një e nga një, zoti kryetar.

Ulsi Manja – Bëji të tria bashkë.

Adriatik Alimadhi – E kam qejfin kështu, mos ma prish.

Ulsi Manja – Po mirë, në rregull! Dakord, dakord!

Po, zoti Ibrahim, në lidhje me pyetjen e kolegut Alimadhi.

Gent Ibrahim – Patjetër!

Në fakt, kjo lidhet edhe me atë pyetjen e përgjithshme, në lidhje me mënyrën se si ne i trajtojmë ankesat, konstatimet. Kjo nuk është një ankesë e zakonshme, që vjen nga një anëtar i publikut, por një konstatim që vjen nga Kryeministri në sallën e Kuvendit. Si i tillë, pra si konstatim i përgjithshëm politik, nuk mund të vërë në lëvizje një procedurë të mirëfilltë disiplinore nga ana e këshillit. Në rastet tipike të ankesave, ne i marrim ato, u bëjmë një shqyrtim shumë të përciptë, sepse dua të kujtoj se ne nuk mund të biem në pozitë e paragjykit. Ne jemi ata që, këto ankesa, eventualisht, pas disa muajsh do t’i shqyrtojmë si gjykatë. Ato vinë gabimisht tek ne, por megjithatë, ne nuk i neglizhojmë. U bëjmë një shqyrtim fare të përciptë, për të kuptuar se ku duhet të shkojnë dhe kush është përgjegjës për t’i hetuar ato, por pa u futur në thelb, sepse pastaj do të paragjykonim rolin tonë si gjykatë. Sepse nesër ky do të jetë roli ynë. Pasi t’i hetojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, pasi atij ose asaj do t’i dalë llogaria, që: ‘po, këtu është vendi për të nisur një procesin disiplinor’, atëherë futemi në lojë ne, si gjykatë, për të vendosur masën disiplinore, në nëse është vendi.

Në raste të tilla, ne veprojmë në mënyrë të përgjithshme, ashtu sikundër veproi Kryeministri në mënyrë të përgjithshme, nëpërmjet atij konstatimi, edhe ne vepruam në mënyrë

të përgjithshme, duke i thënë Kryeministrit me atë rast, se deklarata përbën paragjykim të proceseve ligjore në proces.

Ulsi Manja – Zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Në fakt, ju e keni përmendur në raport, por e thatë edhe këtu, në lidhje me tre kandidaturat për Prokuror të Përgjithshëm. Ju thatë: së shpejti. A mund të kemi një afat, edhe për shkak të opinionit publik? Të themi të drejtën, disa thonë se është e jashtëligjshme, jokushtetuese e të tjera, por besoj se për opinionin publik bën sens. A mund ta kemi një afat?

Gent Ibrahim – Zoti Alimadhi, e thashë edhe pak më parë, se nuk do të doja të jepja afate, ngaqë ky është një gabim të cilin e kam bërë disa herë, por ne mendojmë se të hënën do të kemi dritën jeshile nga gjykata, për të vijuar... Gjykata është e detyruar që brenda shtatë ditëve të marrë vendim në lidhje me ankimin e ish-kandidatit. Për sa na takon neve, zotëria është ish-kandidat, sepse nuk i plotëson kushtet që të konkurrojë për Prokuror të Përgjithshëm, e kjo për faktin shumë të thjeshtë se zotëria nuk ka pesëmbëdhjetë vjet punë. Jo punë si jurist i spikatur, sepse kemi zgjedhur të mos i futemi fare këtij aspekti, pra spikatjes, për të mos ia vështirësuar punën edhe gjykatës. Ne thjesht themi se këtu mungojnë pesëmbëdhjetë vjet karrierë në profesion, gjë që do të duhej të qe e qartë për këdo, dreqi ta hajë, por megjithatë ne kemi një sistem ligjor që u garanton të drejta të gjithëve. Në këto kushte, edhe zotëria është i lirë ta sfidojë vendimin tonë dhe të marrë përgjigjen nga gjykata.

Në momentin që marrim këtë përgjigje, ne fillojmë menjëherë pikëzimin e kandidatëve. Ky është një proces shumë i shkurtër. Ne kemi gati tabelat. Janë tre-katër kritere. Kemi edhe intervistat. Ne i njoftojmë kandidatët 10 ditë përpara, në lidhje me datën e intervistës, kështu që, në rast se të hënën marrim vendimin e gjykatës, të martën jemi në gjendje të aktivizojmë procesin. U themi kandidatëve, që pas dhjetë ditësh duhet të jenë në këshill për intervistat. Më pas bëjmë pikëzimin, sepse intervista është pjesë e pikëzimit. Kësisoj, kur të japim pikët, do të na duhet edhe t'i kemi dëgjuar kandidatët, por pikëzimi bëhet brenda një dite. Shumë-shumë brenda dy ditësh, sepse tre kandidatë janë, nuk është ndonjë punë e madhe.

Çdo anëtar i këshillit do të marrë në dorë fletën dhe do të vërë pikët. Më pas, ato pikë thjesht mblidhen. Është një proces i thjeshtë aritmetik. Deri në përfundim të aritmetikës, ne mund të kemi listën, të cilën jua dërgojmë juve.

Kështu, i vetmi afat që mund t'u jap, është që, nga momenti që marrim vendimin e gjykatës, ne u japim kandidatëve edhe dhjetë ditë kohë që të përgatiten për intervistat dhe pasi të kryhen intervistat, të cilat do të bëhen të gjitha në një ditë, ne i japim vetes 1 apo 2 ditë kohë

për të bërë procesin e pikëzimit dhe atëherë Kuvendi do të ketë listën e kandidatëve të renditur sipas radhës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Zoti Alimadhi, pyetja e fundit.

Adriatik Alimadhi – Edhe një pyetje të fundit, ma përcaktohet...

Ulsi Manja – Tri pyetje kishit, sepse numri 3 nuk është 4.

Adriatik Alimadhi – Dua një përgjigje profesionale nga ana juaj. Unë e di që ju jeni ndër ato personalitete që hyni më shumë në pjesën administrative sesa në pjesën teknike. Në fakt, kam qenë i pranishëm, me ftesën që ju na kishit bërë, për promovimin e prokurorëve dhe të magjistratëve që ishin emëruar si prokurorë dhe gjyqtarë, e cila u bë në muajin korrik. Dua të di si ju duket emërimi i magjistratëve, sepse ata janë emëruar rishtas. A është kjo pjesa e re më e mira e përzgjedhjes e futur në këtë sistem, apo një pjesë tjetër, mendimi im, e prokurorëve, të cilët ishin brenda sistemit? Kam parasysh këtu edhe ecurinë e jetës sime, që dikur, kur kam filluar punë, kam pasur edhe unë problemet e mia. A është më i përshtatshëm kontingjenti që ju keni zgjedhur?

Përgjigjen e dua më shumë nga ana profesionale. Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim – Do të thosha se është një pyetje njerëzore, pa dyshim. Ajo çka po shohim është që ne jemi të detyruar të largojmë nga sistemi njerëz, të cilët i kanë shërbyer për vite me radhë e gjatë këtyre viteve kanë akumuluar një pasuri në tërë, në kuptimin e aftësive profesionale, por me sa duket vitet e akumulimit profesional ndonjëherë janë edhe vite të cedimit sa i takon integritetit. Unë mendoj se sistemi i ri pa dyshim do të përfitojë shumë sa i takon integritetit me hyrjet reja, pasi këta njerëz janë futur në sistem pasi janë vetuar dy herë, siç jua shpjegova edhe pak më lartë. Atyre do t'ju duhet kohë të japin performancën maksimale nga ana profesionale, por besoj që po t'i vësh në kandar integritetin dhe profesionalizmin, i pari do të duhet të rëndojë më shumë, sepse në rast se i futesh trajtimin të një çështjeje me ndershmëri dhe seriozitet, gjasat për t'i dhënë zgjidhjen e duhur janë më të mëdha, nëse në dispozicion ke vetëm aftësitë profesionale. Plus që kemi edhe garancinë që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës dhe kanë një farë praktike profesionale.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Fjalën e ka kërkuar zonja Bode.

Më pas fjalën e ka zonja Xhina për pyetje.

Edlira Bode – Faleminderit, kryetar!

Falënderoj zotin Ibrahimimi dhe gjithë të pranishmit për sqarimet!

Ne vijmë nga një sistem drejtësie i pranuar gjerësisht si i padrejtë, i korruptuar dhe me njerëz pa integritet, ky është edhe qëllimi i miratimit dhe i zbatimit të reformës në drejtësi. Unë, ndoshta ndryshe nga të gjithë kolegët, ju shoh më shumë si publik, sepse nuk jam profesioniste e ligjeve. Ju folët për ndihmën që u jepni organeve të vetëqeveritjes në drejtësi të aspektit profesional të prokurorëve. Fatkeqësisht, shpeshherë në medie gjejmë sulme publike edhe ndaj organeve të reja, të cilat do t'i quaja të padrejta. Pyetja ime është, a keni ju një fjali apo disa fjali, një argument apo disa argumente, pse duhet të besojë publiku që përfundimet tuaja janë të drejta në lidhje me profesionistët që merrni në analizë? Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bode!

Zoti Ibrahimimi.

Gent Ibrahimimi – Faleminderit!

Kjo është një pyetje tjetër që e çmoj shumë dhe nuk e kam të vështirë t'i vë epitetin “njerëzore”, pavarësisht se vjen nga një politikan.

Pse ne mund ta shohim në sy publikun dhe t'i themi që këto që ne bëjmë janë më të mira dhe më të sakta se ato që janë bërë për të njëjtat çështje në të kaluarën? Përgjigjja e thjeshtë ndaj kësaj pyetjeje është fakti që ne jemi një organ kolegjal, i cili përmbledh në vetvete botëkuptime, këndvështrime, eksperiencë të 11 njerëzve. Përzgjedhja jonë, të paktën në rrafshin e profesioneve dhe të origjinës sonë profesionale, të vendeve nga vijmë është e tillë që garanton larminë e këndvështrimeve për të njëjtën çështje.

Po ju jap një shifër shumë të thjeshtë. Ne sot jemi një organ me 11 anëtarë dhe ushtrojmë vetëm 1/3-ën e kompetencave që ushtronte dikur Prokurori i Përgjithshëm. Pra, një njeri i vetëm kishte të gjitha kompetencat që ne kemi sot, por kishte edhe 3 herë më shumë kompetencë. Besoj se garancitë janë evidente, pasi për çdo vendim për caktimin e përkohshëm të një prokurori, për ngritjen në detyrë të një prokurori janë 11 njerëz që futen në vlerë, plus faktin që vendimet tona paraprihen nga raporte vlerësimi, përbërja e të cilave paracaktohet në ligj. Nuk mund t'i bësh bisht apriori, nuk mund të lësh mënjatë një faktor apo një faktor tjetër në marrjen e vendimeve, por duhet të tregosh që ky person, i cili po promovohet në prokurorinë e posaçme ka performuar më mirë sesa një tjetër, i cili gjithashtu kandidon për këtë. Të shohësh produktet e punës së komisionit tonë të posaçëm për vlerësimin e kandidatëve për në SPAK mendoj se çdokush do të impresionohet. Janë volume të tëra, çështje konkrete të zgjedhura nga vetë kandidatët që janë shqyrtuar me imtësi nga grupi i vlerësimit dhe ato janë ballafaquar me njëra-tjetrën për të arritur në përfundimin se ky është pak më i mirë se ai tjetri. Ne këtë procedurë në

mënyrë artistike e kemi quajtur si një “konkurs bukurie”, në kuptimin, ku pasi kemi arritur në përfundimin që të gjithë janë të përshtatshëm për të shërbyer në SPAK po shohim se cili është pak më i mirë se tjetri.

Për këto arsye dhe për faktin që ne veprojmë si një trupë kolegjiale në një fushë kompetencash shumë më të ngushtë sesa ajo që dikur ushtronte prokurori i Përgjithshëm, në bazë të procedurave dhe të kriterëve të publikuara paraprakisht dhe të njohura nga kandidatët, besoj se publiku duhet ta ketë besimin që produktet tona janë më të ndershme dhe profesionale.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Zonja Xhina, e ka kërkuar fjalën për pyetje.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zotin Ibrahim dhe gjithë anëtarët e pranishëm nga KLP-ja, si dhe ju përgëzoj për punën tuaj! KLP-ja është një institucion i ri i krijuar dhe në këtë mënyrë duhen shtruar shinat për mënyrën e funksionimit të tij, nga ana tjetër keni edhe shumë çështje me fokus të ndryshëm dhe koha kërkon që ju t’i shqyrtoni.

Një nga problematikat që ju shtruat ishte ajo e vakancave të krijuara deri më sot në prokurori për shkak të vetingut, por edhe që priten realisht të krijohen në vazhdim. Pyetja ime është: a mund të na thoni sa studentë që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës janë në pritje për të kaluar këtë “minivetingun” që ju na thatë pak më parë? Kam parasysh që në janar të këtij viti keni filluar t’i shqyrtoni dhe deri më sot keni bërë 6 emërimë. Me çfarë ritmesh do të vazhdojë minivetingu i personave që janë në pritje? A ka pasur ndonjë rast që ndonjë student që ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës e ka kaluar këtë minivetingun që ju bëni? Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Zoti Ibrahim, fjala për ju.

Gent Ibrahim – Faleminderit!

Po, vakanca është një problem madhor që është krijuar. Siç jua thashë, ne jemi në gjendje të kuptojmë se sa do të jetë numri i vakancave që do të vijnë të krijohet dhe do të mundohemi t’i përgjigjemi kësaj përmes një ritmi të caktuar të prodhimit të kandidatëve për prokurorë nga Shkolla e Magjistraturës. Sidoqoftë, kjo llogari duhet të kushtëzohet edhe nga kapacitetet e Shkollës së Magjistraturës.

Sa i takon ecurisë së minivetingut, por siç jua thashë nuk është kaq mini, thjesht unë e quaj “mini” për ta dalluar me vetingun që u bëhet gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, ne kemi kaluar 23 studentë, në qoftë se nuk jam i gabuar, të cilët e kanë fituar të drejtën për të

studiuar në Shkollën e Magjistraturës, por ende jo. Pra, ata kanë fituar provimin, i cili është një nga kushtet që duhet të plotësojë një student për të hyrë në këtë shkollë, ndërsa kushti tjetër është që të kalojë vetingun e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ne kemi proceduar deri tani 18 prej tyre, të cilëve u kemi dhënë dritën jeshile për të studiuar në Shkollën e Magjistraturës dhe kemi në proces 5 të tjerë.

Pa dyshim, jemi duke vetuar edhe 10 prokurorë të rinj, të cilët e kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës...

Pyetja ishte për këta të dhjetë?

(Diskutime pa mikrofon)

Sa u takon këtyre jemi në fazën finale dhe nuk parashikojmë ndonjë vështirësi në kuptimin që të ketë ndonjë arsye dhe këta persona...

(Diskutime pa mikrofon)

Me këta mbyllet. Vitin që vjen, për fat të keq, ne presim nga Shkolla e Magjistraturës vetëm dy kandidatë për prokurorë, ndërsa në vitin pasardhës zero kandidatë për prokurorë, për shkak të paaftësisë suaj për të marrë një vendim, për të bërë një amendament në ligj, kështu që ndoshta është vendi t'i lëmë përgjegjësitë aty ku janë, siç e lamë te vetingu për vonesat. Fakti që sistemi i prokurorisë në vitin pasardhës do të marrë zero kandidatë për prokurorë është përgjegjësia e Kuvendit të Shqipërisë.

Ju mund ta ndani politikisht, por duhet të kishit miratuar një amendament në ligj, sepse në kushtet kur nuk ishte krijuar ende Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili nuk mund të thoshte sesa studentë do të pranonte, duhet ta kishit bërë nëpërmjet një amendamenti në ligj dhe ky është një problem serioz, të cilin do të duhet ta adresojmë në vitet pasardhëse, duke rritur ritmin e pranimeve në Shkollën e Magjistraturës. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Fjalën e ka kërkuar zoti Përmeti për pyetje dhe më pas kolegja Mara.

Andi Përmeti – Zoti Ibrahim, në fakt, unë doja të diskutoja, kështu që po e konkludoj me një pyetje në formë diskutimi. Ne, për shkak të profesionit që kemi, takojmë përditë qytetarë shqiptarë, të cilët, të jemi i sinqertë, kanë shumë shpresë te SPAK-u, e ashtuquajtura “drejtësi e re”. Qytetarët shpresojnë që SPAK-u do të bëjë diferencën midis Shqipërisë së vjetër me njerëz të korruptuar që kanë shfrytëzuar gjithmonë pozicionin për të mbushur xhepat e tyre dhe të një Shqipërie që do të jetë më parimore, më e mirë dhe më europiane. Shumica e tyre kanë shpresën se do të rivendoset edhe dinjiteti i tyre i nëpërkëmbur, duke dënuar edhe politikanë, të cilët për 30 vjet rresht e kanë shfrytëzuar këtë vend duke vjedhur taksat e tyre. Unë do t'ju

uroja suksese në punën tuaj dhe besoj se keni bërë një punë të mirë, gjithashtu do të uroja që SPAK-u të ngrihet sa më parë.

Urimin e fundit, të cilin do të më duhet ta bëj në formë pyetjeje meqë jemi në fazën e pyetjeve, unë dhe shqiptarët shpresojmë që SPAK-u të paktën të mos konkludojë si vetingu, flas për deri më sot, që, pavarësisht se çfarë ka bërë dikush, se çfarë ka vjedhur dhe ka marrë në kurriz të këtij populli ai të tërhiqet nga politika dhe të rrijë në shtëpinë e tij i qetë, duke prishur paratë. Shpresoj që SPAK-u të konkludojë në dënime politikanësh të korruptuar përgjatë 30 vjetëve që ka pasur ky vend dhe jo vetëm me largimet e tyre nga politika për t'i shijuar këto para.

Këto ishin pak a shumë ato që doja të thosha, por, duke qenë i detyruar t'i shndërroja në pyetje po jua bëj atë. A besoni ju që SPAK-u do të konkludojë deri në dënimin e politikanëve të niveleve të larta dhe jo vetëm në largimin e politikanëve të çdo niveli apo të çdo partie nga frika e SPAK-ut? Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Përmeti!

Zoti Ibrahim, fjala për ju.

Gent Ibrahim – Jam dakord me konstatimin tuaj që për suksesin apo dështimin e SPAK-ut ka vetëm dy tregues, aftësia për të vënë para përgjegjësisë funksionarët e lartë të shtetit dhe aftësia për të goditur me efikasitet krimin e organizuar, sepse shpeshherë këtë të dytin e harrojmë, por është po aq i rëndësishëm dhe mendoj se kjo është arsyeja përse po na vonohen negociatat.

Mund t'ju them që SPAK-u i ka të gjitha kushtet ligjore, politike po të doni, në kuptimin e mbështetjes, për të qenë funksional. Në çfarë kuptimi? Në SPAK po shkojnë njerëz, të cilët kanë kaluar në kokën e gjilpërës, qoftë nga organet e vetingut, qoftë nga ana jonë si këshill sa u takon aftësive profesionale. Në momentin që shkojnë aty këta zonja dhe zotërinj do të paguhën më shumë se Presidenti i Republikës. Ne kemi një tjetër propozim në tryezën e Këshillit të Ministrave për një rritje të mëtejshme të pagës prej rreth 50% të prokurorëve të SPAK-ut. Pra, në rast se të gjithë prokurorët e Shqipërisë do të paguhën shumë më tepër sesa paguheshin më parë ne kemi propozuar që përmes një mënyre teknike, që është përdorur nga Këshilli i Ministrave në caktimin e pagës për anëtarët e organeve të vetingut, edhe paga e atyre të rritet dhe ata do të paguhën shumë më tepër se Presidenti i Republikës, do të kenë sigurinë e qëndrimit në detyrë për 9 vjet, do të administrojnë vetë shërbimet administrative, mbështetjen policore të punës së tyre. Vetë këshilli, që i dërgon këta njerëz në këto pozicione, do ta ketë shumë të vështirë t'i verë para përgjegjësisë, aq sa vetë ne tani do të fillojmë të shqetësohemi

për të kundërtën, përgjegjshmërinë e tyre, sepse deri tani jemi shqetësuar vetëm për pavarësinë e tyre dhe kemi bërë çmos që ata të marrin gjithçka. Shpresoj që të mos e kuptojnë që nuk kemi bërë aq sa duhet sa i takon përgjegjshmërisë. Në këto kushte, pavarësi e plotë, pagesë e hijshme, siguri pune, mbështetje e plotë administrative, policore, mbështetje e plotë ndërkombëtare, besoj se produkti nuk do të vonojë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ibrahim!

Zonja Mara, e ka fjalën.

Aurora Mara – Faleminderit, zoti kryetar!

Ju falënderoj për ekspozenë e punës dhe për të gjitha shpjegimet, madje besoj se ishit shumë e qartë edhe për publikun.

Faktikisht vetingu është një proces shumë i vështirë, megjithatë vonesat, kohëzgjatja, pengesat që dalin rrugës na bëjnë të kuptojmë se është i domosdoshëm. Nga ana tjetër, shtohet frika për kontingjentin që ende nuk e ka kaluar vetingun. A keni ju një strategji pune gjatë kësaj kohe për të gjitha problemet që dalin rrugës gjatë të gjitha dorëheqjeve? A keni menduar një strategji pune, apo keni hartuar një strategji monitorimi të shtuar, gjatë kësaj kohe deri sa të gjithë të kalojnë në sitën e vetingut?

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Mara!

Zoti Ibrahim.

Gent Ibrahim – Faleminderit!

Ky është një shqetësim, do të thotë që po të bësh një llogari me afatet që parashikon ligji sot, procesi i vetingut do të duhet të vazhdojë të paktën edhe tre vjet, mbase edhe më shumë, por me ligjet që kemi sot ai do të vazhdojë edhe tre vjet. Në këto kushte shqetësimi juaj është i drejtë, pra që ndërkohë në sistem ka prokurorë të inkriminuar dhe jo profesionalë. Ky është një problem serioz, i cili mund të adresohet në disa mënyra, por shumica e tyre janë në domenin e politikës, sepse kërkohet politikëbërje dhe ligjëbërje. Ne kemi ato kompetenca që kemi dhe që na jep ligji, që në thelb na bëjnë në një gjykatë, e cila për nga natyra është në pozicion pritës. Ne duhet të shqyrtojmë produktin e punës së inspektorit të lartë të drejtësisë sa i takon shkeljeve disiplinore. Pa dyshim që ne bëjmë vlerësimin profesional, i cili është një rrugë afatgjatë për të arritur në përfundime në lidhje me integritetin e prokurorëve. Në këto kushte kam frikë se nuk ka shumë se çfarë mund të bëjë Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ju si legjislatorë keni më shumë për të bërë.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Meqenëse kolegët i bënë pyetjet që kishin, si kryetar i komisionit, por edhe si relator i të gjitha ligjeve të sistemit të drejtësisë penale në Komisionin e Posaçëm të Reformës në Drejtësi, por edhe për shkak të formimit tim si jurist dhe si prokuror e gjej me vend të them disa fjalë në këtë seancë raportimi, por edhe në lidhje me punën tuaj të deritanishme si institucion kushtetues.

Së pari, Kuvendi i njeh përgjegjësitë e veta në lidhje me suportin dhe mbështetjen që i ka dhënë dhe duhet të japi institucioni që ju drejtoni, sa i përket buxhetimit të strukturës, në burimet e nevojshme njerëzore, por edhe në infrastrukturën e duhur që ju të punoni dhe të ushtroni detyrat që ju ka ngarkuar Kushtetuta dhe ligji. Si Komisioni i Ligjeve dhe si Kuvend njohim përgjegjësinë për të adresuar të gjitha ndryshimet e duhura ligjore që ju do të sillni në Kuvend. Në këtë fazë unë dua t'ju falënderoj për punën, por, duke njohur të gjitha vështirësitë e këtij institucioni të krijuar nga e para dhe të një mungesë të një tradite sa i përket sistemit të drejtësisë penale, kur dihet që ne kemi pasur një model tjetër të funksionimit të organit të prokurorisë, numri i vendimeve që ju keni marrë është për t'u përshëndetur. Jam i bindur që në këtë vendimmarrje keni arritur në metrat e fundit, siç thatë ju, për të pasur një Prokuror të Përgjithshëm me mandat kushtetues, për të cilin jo vetëm procesi ka rëndësinë e duhur, por edhe përzgjedhja, sepse, nëse Kuvendi i Shqipërisë nuk do të arrijë ta zgjedhë me 84 vota Prokurorin e Përgjithshëm, keni në dorë t'i jepni Shqipërisë Prokurorin e Përgjithshëm me mandat të plotë kushtetues që do të drejtojë sistemin për 7 vjetët e ardhshëm dhe do të përfaqësojë organin e prokurorisë edhe në marrëdhënie me të tretë, por edhe me institucionet ndërkombëtare.

Në fakt, jemi në momentet e fundit edhe për krijimin e SPAK-ut. Këtu dua të ndalem edhe për të përçuar një mesazh për opinionin publik, për shkak të interesimit të mediave që janë sot prezent. Mirë bëni që nuk jepni afate, por në fund të këtij viti Shqipëria duhet të ketë edhe Prokurorin e Përgjithshëm me mandat kushtetues, por edhe strukturën e posaçme për të luftuar krimin dhe korrupsionin në radhët e zyrtarëve të lartë. Nuk ka dilema për kuadrin kushtetues dhe ligjor. Kemi 8 prokurorë që janë kandidatë për në SPAK, për të cilët vendimi i komisionit të kualifikimit ka marrë formën e prerë. Personalisht ndaj mendimin që Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të duhet të respektojë në frymë dhe germë Kushtetutën e vendit, ekzatësisht nenin 148 “dh”, pika 2, të Kushtetutës, kur thotë që Prokuroria e Posaçme përbëhet nga të paktë 10 prokurorë. Është përcaktim i qartë kushtetues, por kuadri ligjor që kemi në fuqi e ka zgjidhur këtë, mjafton që ju t'i referoheni ligjit të statusit të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Kemi goxha prokurorë sot në sistem, të cilët e kanë kaluar me

sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe që mund të shfrytëzohet hapësira e ligjit ose përcaktim të përkohshëm në detyrë, ngritje në detyrë, ose lëvizje paralele. Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, prokurorët në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, i lejon në lëvizje paralele. E rëndësishme është respektimi i përcaktimit kushtetues në momentin e krijimit të strukturës. Ky është mendimi im, por besoj edhe i frymës së ligjit që struktura në momentin e krijimit do të duhet të ngrihet duke u kujdesur që t'i respektojmë integritetin asaj strukture. Një strukturë që mund të ngrihet duke u cenuar ky përcaktim kushtetues, në vlerësimin tim, do të ishte e lehtë për ta sulmuar nga politika, pra do të kishte një hapësirë ku politika mund ta sulmonte këtë strukturë ku i kanë sytë të gjithë shqiptarët. Unë bashkohem me mendimin tuaj se kjo strukturë me të gjitha këto garanci ligjore që ne ofrojmë për strukturën e garanton suksesin. Më vjen mirë që paska një propozim konkret të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për t'i trajtuar prokurorët e SPAK-ut me të njëjtën mënyrë, siç trajtohen anëtarët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe mirë keni bërë.

Qëllimi i ligjit për SPAK-un ka qenë që jo vetëm prokurorët e krimeve të rënda, por edhe prokurorët më të mirë të sistemit të drejtësisë, që do ta kalonin me sukses vetingun, të ishin pjesë e kësaj strukture. Ky ka qenë qëllimi i ligjvënësve. Unë shpresoj se metrat e fundit për të dyja këto institucione të rëndësishme kushtetuese të përmbyllen me sukses. Mundësitë janë. Ne jemi të gatshëm të japim çdo lloj suporti qoftë në buxhetim, meqenëse jemi në fazën e diskutimit të buxhetit për vitin e ardhshëm, por edhe me ndërhyrjet e duhura ligjore. Le të themi se këtu është rasti të përshëndesim opozitën në Kuvend, që dha mbështetjen për ndryshimet e shumëpritura në ligjin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, zhbllokuan edhe situatën e pranimeve në Shkollën e Magjistraturës, por për ligjin e statusit në lidhje me kapitullin për masat disiplinore, opozita është treguar e gatshme për të suportuar të gjitha ndryshimet e duhura ligjore që do të vijnë si rezultat i zbatimit praktik të ligjit, qoftë nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, qoftë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pra, Kuvendi ka gatishmërinë e duhur për ta suportuar deri në fund punën e institucionit që ju drejtoni.

Së fundi, ju inkurajoj të vazhdoni bashkëpunimin me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Jeni dy institucione kushtetuese që, për sa kohë do të funksionojë procesi i vetingut, puna e këtyre dy institucioneve është e ndërvarur, nuk duhet të shihet bashkëpunimi i institucionit që ju drejtoni dhe Komisionit të Pavarur të Kualifikimit thjesht si bashkëpunim ose më saktë ju duhet të kujdeseni të mos cenoni pavarësinë e njëri-tjetrit, se Komisioni i Pavarur i Kualifikimit tregohet hermetik në disa raste, por është detyrim kushtetues

bashkëpunimi. Ju keni në dorë procesin e rivlerësimit sa i përket komponentit të aftësive profesionale, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit natyrisht ka edhe dy komponentë të tjerë, që lidhen me pasurinë dhe figurën, por është i domosdoshëm bashkëpunimi mes jush për ta shpejtuar procesin e vetingut. Jemi në hapat e para të procesit të vetingut, deri tani kanë kaluar rreth 100 prokurorë, është një numër i pakët po të kemi parasysh faktin se në materialin që ju keni raportuar në komision janë 336 prokurorë në sistem që presin të kalojnë procesin e rivlerësimit kalimtar, siç është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi në këtë fazë tranzitore deri sa të ngrihet Inspektori i Lartë i Drejtësisë në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm. Le të themi këta prokurorët që janë në pritje të vetingut dhe që në situata të caktuara kanë sjellje jo korrekte me ligjin, por edhe me Kodin e Etikës së Prokurorit do të duhet të marrin edhe ndëshkimin e duhur nëpërmjet një hetimi dhe procesi disiplinor edhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

Më vjen mirë që ndryshimet që i bëmë ligjit në korrik e kanë zgjidhur situatën që Prokurori i Përgjithshëm e fillon hetimin disiplinor, ka edhe bazën e nevojshme ligjore, por do të duhet të përfaqësohen siç duhet në Këshillin e Lartë të Prokurorisë masat disiplinore konkrete për prokurorë që diskreditojnë figurën e prokurorit. Prokurorë, që në pritje të kalimit të procesit të vetingut, i cili do të zgjasë sipas Kushtetutës për një mandat për 5 vjet, mundohen të shfrytëzojnë funksionin që u ka dhënë Kushtetuta dhe ligji, nuk duhet të kenë vend në sistemin e prokurorisë në rast se shkeljet për të cilat opinioni publik ka ndjeshmëri të caktuara provohen dhe janë evidente nga ky raport pune mes Prokurorit të Përgjithshëm dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Zoti Ibrahim, duke qenë se sot në komision jeni ju dhe nënkryetari, zoti Balla, ju nuk duhet të hezitoni t'i përgjigjeni çdo sensibiliteti të opinionit publik në raport me sjelljen e prokurorëve të caktuar në sistem. Në këtë fazë ku jemi, siç edhe kam inkurajuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, që të përmbyllë në një kohë sa më të shpejtë edhe përzgjedhjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sepse është e qartë, sot sistemit i mungon një krah shumë i rëndësishëm, që është kontrolli dhe llogaridhënia, mision të cilin ia kemi ngarkuar një institucion tjetër kushtetues, që është Inspektori i Lartë i Drejtësisë, por ligji edhe në këtë moment që ne po diskutojmë në komision ka instrumentet e duhura për të, ndëshkuar këdo zyrtar publik qoftë në sistemin e prokurorisë, qoftë në sistemin gjyqësor, që abuzon me ligjin.

Ne mbetemi të hapur si komision, por edhe nëpërmjet raporteve që marr nga një institucion tjetër po i Kuvendit të Shqipërisë, që është komisioni *ad hoc* që monitoron zbatimin e reformës në sistemin e drejtësisë, marrim raporte periodike lidhur me veprimtarinë e

institucionit që ju drejtoni, mbetem i hapur për t'ju mbështetur nëpërmjet Kuvendit, si komision, të jemi zëri dhe avokatia juaj në parlament, por dhe në ekzekutiv për t'ju mbështetur si duhet në gjithçka që ju duhet për të ushtruar si duhet misionin e ngarkuar nga Kushtetuta.

Unë e përgëzoj punën tuaj, por janë 10 muaj dhe nuk është kollaj të ngresh një institucion nga e para, por deri tani janë hedhur themelet të qëndrueshme. Nëse kësaj godine i hedhim themelet e duhura që në fillim, unë jam i bindur në suksesin e këtij institucioni, por merakun ngelet përsëri një dhe vetëm një, Prokurori i Përgjithshëm dhe SPAK-u, me qëllim që t'i hapet rruga krijimit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila, sipas ligjit, kërkon 2 deri në 3 muaj kohë që të funksionojë. E thënë më qartë, nëse tani ngremë SPAK-un, prokurorinë e posaçme antikorruption, kemi mundësinë që në fillim të vitit të ardhshëm, të kemi edhe Byronë Kombëtare të Hetimit si një njësi e posaçme hetimore në funksion të SPAK-ut. Sot janë rreth 400 e ca dosje në duart e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, siç e thatë, por edhe të prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, që për shkak të kompetencës, do t'i marrë SPAK-u në momentin e krijimit. Ka një lëndë të parë që kjo prokurori të vazhdojë punën, por njësi e posaçme hetimore, apo e ashtuquajtura Byroja Kombëtare e Hetimit, e cila do të ketë edhe infrastrukturën e duhur hetimore në dispozicion, do të jetë hallka kryesore që do të Prokurorinë e Posaçme me hetime, me kallëzime dhe me çështje penale. Autoriteti i asaj strukture duhet ta ndajë një herë e përgjithmonë të mirën nga e keqja në këtë vend.

E tha edhe kolegu Përmeti, çelësi dhe baza e suksesit të reformës në drejtësi, në një masë të konsiderueshme, është e varur nga sukse i SPAK-ut. Ne do ta kishim, se ne jemi një shtet gati 30 vjet në demokraci, kemi Gjykatë Kushtetuese, kemi Gjykatë të Lartë dhe do ta bëjmë funksionale Gjykatën e Lartë, kemi prokurori, pra institucionet kushtetuese ishin, por risitë e kësaj reforme ishin dy: vetingu, si shtylla kryesore që do të pastrojë sistemin e vjetër dhe SAK-u si strukturë e posaçme që do të pastrojë përfundimisht politikën e korruptuar në këtë vend. Le të punojmë të gjitha palët bashkë, që t'i ndezim dritën jeshile një orë e më parë krijimit të kësaj strukture!

Shumë faleminderit për ekspozenë që bëtë sot për kolegët e mi të komisionit, por edhe për opinionin publik! Ndoshta hera e parë e raportimit të një drejtuesi të një institucioni kushtetues do të mbahet mend përherë, por unë do të shfrytëzoj hapësirat që më jep Rregullorja e Kuvendit që, me këto dy institucione KLGJ-në dhe KLP-në, që ju drejtoni, të vini herë pas here në seancë dëgjimore në këtë komision, sepse jam i bindur se mbështetja që i japim njërit-tjetrit garanton suksesin.

Edhe një herë faleminderit kolegëve, zotit Ibrahim, zotit Balla, dy zonjave që ju shoqërojnë, medieve për pasqyrimin korrekt të kësaj seance dëgjimore, por edhe të gazetarëve, të cilët që ditën e parë e deri sot kanë qenë mbështetja e reformës në drejtësi dhe vazhdojnë të jenë! Jam i bindur se ky është një mision i përbashkët, që ia kemi borxh publikut. Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA